



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3318/7 prot.

Datë 11.12.2024

V E N D I M
Nr. 1761/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 11.12.2024 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “INSTITUTI I KONSULENCES NE NDERTIM IKN shpk” në procedurën e prokurimit “*E Hapur, e thjeshtuar - Shërbime – Prokurim me mjete elektronike*” me nr. **REF-24751-10-15-2024**, me objekt: “*Supervizion punimesh Ndertim rruga kthesa e Berdices - Ura e Bahcallekut*” me fond limit **9,191,815.2** (nëntë milion e njëqind e nëntëdhjetë e një mijë e tetëqind e pesëmbëdhjetë presje dy), zhvilluar më datë 30.10.2024 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertave të paraqitura nga ofertuesit pjesëmarrës të kualifikuar në këtë procedurë prokurimi, OE “ARENA MK” shpk; OE “CIVIL CONS” shpk; OE “HTS COMPANY” shpk; OE “INFRA – PLAN” shpk; OE “SEED CONSULTING” shpk; si dhe OE “TRANSPORT HIGHWAY CONSULTING” shpk

Ankimues: Operatori ekonomik “INSTITUTI I KONSULENCES NE NDERTIM IKN shpk” me NIPT K71828007J dhe adresë Tiranë, Rr. Eduard Mano, Nd.8, H.1, Ap.3.

Subjekt i interesuar: OE “SEED CONSULTING” shpk me NIPT L41824014Q dhe adresë Shqiperi Tirane Tirane Tirane, , Rruga Perlat Rexhepi, Nd.8, H.1, Ap.14.

OE “ARENA MK” shpk me NIPT L67619801Q dhe adresë Ballsh Fier Ballsh, , Fshati Ninësh; Rruga Dames -Ninesh; Ndertesa 4; Lagja Memaj; Nj.Adm.Fratar; Bashkia Mallakaster.

OE “INFRA - PLAN” shpk me NIPT K62225011F dhe adresë Tirane Tirane Tirane, , Rruga :Brigada VIII, Nd. 23, H.16, Ap.49, Njesia Bashkiake 5, TIRANE.

OE “HTS COMPANY” shpk me NIPT M11619018P dhe adresë Tepelene Gjirokaster Tepelene, , Tepelene, Lagjia "Mustafa Matohiti", banesa nr.31, shkalla nr 1, ish Konvikti.

OE “TRANSPORT HIGHWAY CONSULTING” shpk me NIPT K51428048I dhe adresë Komuna e Parisit, Rruga "Osman Myderizi", pallati "Shkreli", Tiranë.

OE “CIVIL CONS” shpk me NIPT L81315015O dhe adresë Gjirokastër, Lagjia 18 Shtatori, Rruga "18 Shtatori", godine 9- kateshe, kati 1-re, objekti 15/5.

Autoriteti Kontraktor: Autoriteti Rrugor Shqiptar
Adresa: “Rruga Sami Frashëri nr.33”, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. Për ankesën me nr. elektronik A/2024/4772 dhe me nr. 3318/2024 prot., datë 12.11.2024 e operatorit ekonomik “INSTITUTI I KONSULENCES NE NDERTIM IKN shpk” SHPK, nuk ka plotësuar kushtet formale të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 16.10.2024, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E Hapur, e thjeshtuar - Shërbime – Prokurim me mjete elektronike” me nr. **REF-24751-10-15-2024**, me objekt: “*Supervizion punimesh Ndertim rruga kthesa e Berdices - Ura e Bahcallekut*” me fond limit **9,191,815.2** (nëntë milion e njëqind e nëntëdhjetë e një mijë e tetëqind e pesëmbëdhjetë presje dy), zhvilluar më datë 30.10.2024 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

II.2. Në datën 30.10.2024 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt- ankimi.

II.3. Në datën 06.11.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. OE “CIVIL CONS” SHPK Vlera: 8,000,000.00 (tetë milion) Lekë pa TVSH. Totali i pikëve të marra: 285.00. (I Kualifikuar)
2. **OE “INSTITUTI I KONSULENCES NE NDERTIM "IKN"” SHPK Vlera: 8,209,848.00 (tetë milion e dyqind e nëntë mijë e tetëqind e dyzet e tetë) Lekë pa TVSH. Totali i pikëve të marra: 0 (I Skualifikuar)**
3. BOE “SEED CONSULTING” SHPK & “DERBI-E” SHPK Vlera: 8,304,000.00 (tetë milion e treqind e katër mijë) Lekë pa TVSH. Totali i pikëve të marra: 276.00 (I Kualifikuar)
4. BOE “SËS Consulting Engineering-Structures, Eater & Survey” SHPK & “INFRA - PLAN” SHPK Vlera: 8,400,000.00 (tetë milion e katërqind mijë) Lekë pa TVSH. Totali i pikëve të marra: 277.50 (I Kualifikuar)
5. BOE “ZENIT&CO” SHPK & “GRAMA” SHPK Vlera: 8,640,306.00 (tetë milion e gjashtëqind e dyzet mijë e treqind e gjashtë) Lekë pa TVSH. Totali i pikëve të marra: 0 (I Skualifikuar)
6. BOE “HTS COMPANY” SHPK & “HE & SK 11” SHPK Vlera: 8,900,000.00 (tetë milion e nëntëqind mijë) Lekë pa TVSH. Totali i pikëve të marra: 270.00 (I Kualifikuar)
7. BOE “TRANSPORT HIGHWAY CONSULTING” SHPK & “M.A.G PARTNERS” SHPK Vlera: 8,950,000.00 (tetë milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) Lekë pa TVSH. Totali i pikëve të marra: 268.50 (I Kualifikuar)
8. OE “ARENA MK” SHPK Vlera: 8,000,000.00 (tetë milion) Lekë pa TVSH. Totali i pikëve të marra: 265.50 (I Kualifikuar)

II.4. Në datën 13.11.2024, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE “Formular Njoftim Fituesi Paraprak” për procedurën e prokurimit dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 80, datë 18.11.2024, në të cilën është shpallur fitues operatori ekonomik “CIVIL CONS” SHPK.

II.5. Operatori ekonomik “INSTITUTI I KONSULENCES NE NDERTIM "IKN" SHPK, rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit për arsyet si më poshtë:

“Skualifikohet oferta e paraqitur nga operatori ekonomikë “Instituti Konsulences Ndertim” sh.p.k pasi nuk ka arritur te paraqesë dokumentacion të plotë dhe të saktë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kriterëve të kërkuara në DST , konkretisht; -Nuk ka plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit sipas pikës 2.3.4. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin mbikëqyrës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë, konkretisht: - Mbikëqyrësin për punimet e mjedisit, që duhet të jetë Inxhinier Mjedisit me licencë dhe me eksperiencë pune në këtë fushë. Nga operatori ekonomik mbikëqyresi per punimet e mjedisit, i paraqitur per kete procedurë nuk është Inxhinier Mjedisit i kerkuar qarte ne DST, por eshte Inxhinier Pyjesh. Sipas Termave të Referencës të shpallura për këtë procedurë prokurimi, si dhe natyrës së kesaj kontrate, kriteri i kërkuar për disponimin e Inxhinierit të Mjedisit si pjesë e realizimit, vendoset pasi kemi të bëjmë me zgjidhjen e problemeve mjedisore duke

përdorur parime shkencore dhe inxhinierike. Roli kryesor i Inxhinierit të Mjedisit në zbatimin e kësaj kontrate është për të zhvilluar apo krijuar strategji për riciklimin dhe menaxhimin e mbetjeve dhe të gjithë faktorëve të tjerë që ndikojnë në mjedis. Paraqitja e një Inxhinieri Pyjesh për të plotësuar këto kriter nuk qendron pasi në këto kontrate nuk kemi të bëjmë me praktika për shfrytëzimin e drurit apo menaxhimin e resurseve pyjore. Gjithashtu, Inxhinieri i pyjeve, nuk ka trajnim të specializuar për të kryer detyrat e një Inxhinieri të mjedisit të nevojshëm për zbatimin e projektit dhe si i tillë nuk mund të paraqitet për përmbushjen e këtij kriteri”.

II.5.1. Në datën 11.11.2024 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2024/4772 dhe me nr. 3318/2024 prot., datë 12.11.2024 e operatorit ekonomik “INSTITUTI I KONSULENCES NE NDERTIM IKN shpk”, ku u konstatua se objekti i saj, lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik. Gjithashtu, kundërshton edhe vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertave të paraqitura nga ofertuesit pjesëmarrës të kualifikuar në këtë procedurë prokurimi, konkretisht, OE “ARENA MK” shpk; OE “CIVIL CONS” shpk; OE “HTS COMPANY” shpk; OE “INFRA – PLAN” shpk; OE “SEED CONSULTING” shpk; si dhe OE “TRANSPORT HIGHWAY CONSULTING” shpk, të cilët pretendohet nga ankimuesi se nuk përmbushin kriterin 2.3.4 të vendosur për kualifikim të bërë nga autoriteti kontraktor, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.5.2. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin për publikim Nr. 3318/2 prot., datë 13.11.2024 lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomikë “INSTITUTI I KONSULENCES NE NDERTIM IKN shpk”, që kundërshton me anë të ankesës me nr. 3318/2024 prot., datë 12.11.2024. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik publikoi pretendimet e ankimuesit, që të skualifikohen operatorët ekonomikë OE “ARENA MK” shpk; OE “CIVIL CONS” shpk; OE “HTS COMPANY” shpk; OE “INFRA – PLAN” shpk; OE “SEED CONSULTING” shpk; si dhe OE “TRANSPORT HIGHWAY CONSULTING” shpk, për mospërmbushjen e kriterit 2.3.4 nga ana e secilit ofertues.

II.5.3. Në përfundim të afatit 5 ditor, brenda të cilit autoriteti kontraktor ka detyrimin ligjor të trajtimit të ankesës dhe daljes me një vendim përfundimtar në lidhje me të, Komisioni i Prokurimit Publik me anë të shkresës nr. 3318/3 prot., datë 25.11.2024, i ka kërkuar autoritetit kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit për procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, të jepen argumentimet përkatëse mbi pretendimet e operatorit ekonomik “INSTITUTI I KONSULENCES NE NDERTIM IKN shpk”, si dhe vendimin e autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II.5.4. Nëpërmjet shërbimit posta, është dërguar nga autoriteti kontraktor shkresa “Kthim përgjigje” me nr. 8995/1 prot., datë 04.12.2024, protokolluar me tonën me nr. 3318/4 prot., datë 10.12.2024.

II.6. Në datën 15.11.2024 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2024/4797 dhe me nr. 3377/2024 prot., datë 18.11.2024 e operatorit ekonomik “INSTITUTI I KONSULENCES NE NDERTIM IKN shpk”, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “INSTITUTI I KONSULENCES NE NDERTIM IKN shpk”, pasi përmbush në maksimum kriteret e vlerësimit dhe vlerësimin me pikë maksimale pasi zotëron të gjitha kapacitetet teknike të nevojshme për përmbushjen e kësaj kontrate shërbimi. Gjithashtu, kundërshton edhe vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertave të paraqitura nga ofertuesit pjesëmarrës të kualifikuar në këtë procedurë prokurimi, konkretisht, OE “CIVIL CONS” shpk; OE “SEED CONSULTING” shpk; si dhe OE “TRANSPORT HIGHWAY CONSULTING” shpk, të cilët pretendohet nga ankimuesi se nuk përmbushin kriterin 2.3.4 të vendosur për kualifikim të bërë nga autoriteti kontraktor, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.6.1. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin për publikim Nr. 3377/2 prot., datë 19.11.2024 lidhur me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “INSTITUTI I KONSULENCES NE NDERTIM IKN shpk”, si dhe me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertave të paraqitura nga ofertuesit pjesëmarrës të kualifikuar në këtë procedurë prokurimi, konkretisht, OE “CIVIL CONS” shpk; OE “SEED CONSULTING” shpk; si dhe OE “TRANSPORT HIGHWAY CONSULTING” shpk, të cilët pretendohet nga ankimuesi se nuk përmbushin kriterin 2.3.4 të vendosur për kualifikim të bërë nga autoriteti kontraktor, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.6.2. Nëpërmjet sistemimit elektronik, është dërguar nga autoriteti kontraktor vendimi “Mbi shqyrtimin e ankesës me numër Aplikimi A/2024/4797, në sistemin e ankesave elektronike” drejtuar operatorit ekonomik ankimues, protokolluar me tonën me nr. 3377/3 prot., datë 25.11.2024 me objekt “Vendim mbi shqyrtimin e ankesës online nga operatori ekonomik “INSTITUTI I KONSULENCES NE NDERTIM IKN shpk, me Nr. Aplikimi A/2024/4797 dhe me nr. 3377/3 prot., datë 18.11.2024 të paraqitur në Autoritetin Kontraktor dhe në Komisionin e Prokurimit Publik në sistemin e ankesave elektronike”, ku konstatohet se e ka **refuzuar** atë.

II.6.3. Nëpërmjet shërbimit posta, është dërguar nga autoriteti kontraktor përsëri me shkresën përcjellëse me nr. 7319/7 prot., datë 26.11.2024, vendimi me nr. 7319/6 prot., datë 25.11.2024 “Vendim mbi shqyrtimin e ankesës online nga operatori ekonomik “INSTITUTI I KONSULENCES NE NDERTIM IKN shpk, me Nr. Aplikimi A/2024/4797 dhe me nr. 3377/3 prot., datë 18.11.2024

të paraqitur në Autoritetin Kontraktor dhe në Komisionin e Prokurimit Publik në sistemin e ankesave elektronike”, drejtuar operatorit ekonomik ankimues dhe subjektev etë interesuara, protokolluar me tonën me nr. 3377/4 prot., datë 02.12.2024, ku konstatohet se e ka **refuzuar** atë.

II.7. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatorët ekonomikë të interesuar në këtë procedurë prokurimi, nuk kanë dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, në formë shkresore apo në sistemin e ankesave elektronike.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e ngritura nga operatorit ekonomik “INSTITUTI I KONSULENCES NE NDERTIM IKN shpk”, për skualifikimin e ofertës ekonomike në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson të ndalet fillimisht në respektimin e kushteve formale të paraqitjes së ankesës nga ana e ankimuesit, njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik ankimues nuk ka bashkëlidhur dokumentin bankar që të vërtetojë, se ka kryer pagesën e tarifës financiare për paraqitjen e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me përcaktimet në pikat 2 dhe 4 të nenit 111 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Konkretisht, KPP vëren se,

III.1.1. Në datën 16.10.2024, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E Hapur, e thjeshtuar - Shërbime – Prokurim me mjete elektronike” me nr. **REF-24751-10-15-2024**, me objekt: “*Supervizion punimesh Ndertim rruga kthesa e Berdices - Ura e Bahcallekut*” me fond limit **9,191,815.2** (nëntë milion e njëqind e nëntëdhjetë e një mijë e tetëqind e pesëmbëdhjetë presje dy), zhvilluar më datë 30.10.2024 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

III.1.2. Në datën 30.10 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt- ankimi.

III.1.3. Në datën 06.11.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. OE “CIVIL CONS” SHPK Vlëra: 8,000,000.00 (tetë milion) Lekë pa TVSH. Totali i pikëve të marra: 285.00. (I Kualifikuar)

2. OE “INSTITUTI I KONSULENCES NE NDERTIM "IKN"” SHPK Vlera: **8,209,848.00 (tetë milion e dyqind e nëntë mijë e tetëqind e dyzet e tetë) Lekë pa TVSH. Totali i pikëve të marra: 0 (I Skualifikuar)**
3. BOE “SEED CONSULTING” SHPK & “DERBI-E” SHPK Vlera: 8,304,000.00 (tetë milion e treqind e katër mijë) Lekë pa TVSH. Totali i pikëve të marra: 276.00 (I Kualifikuar)
4. BOE “SËS Consulting Engineering-Structures, Eater & Survey” SHPK & “INFRA - PLAN” SHPK Vlera: 8,400,000.00 (tetë milion e katërqind mijë) Lekë pa TVSH. Totali i pikëve të marra: 277.50 (I Kualifikuar)
5. BOE “ZENIT&CO” SHPK & “GRAMA” SHPK Vlera: 8,640,306.00 (tetë milion e gjashtëqind e dyzet mijë e treqind e gjashtë) Lekë pa TVSH. Totali i pikëve të marra: 0 (I Skualifikuar)
6. BOE “HTS COMPANY” SHPK & “HE & SK 11” SHPK Vlera: 8,900,000.00 (tetë milion e nëntëqind mijë) Lekë pa TVSH. Totali i pikëve të marra: 270.00 (I Kualifikuar)
7. BOE “TRANSPORT HIGHWAY CONSULTING” SHPK & “M.A.G PARTNERS” SHPK Vlera: 8,950,000.00 (tetë milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) Lekë pa TVSH. Totali i pikëve të marra: 268.50 (I Kualifikuar)
8. OE “ARENA MK” SHPK Vlera: 8,000,000.00 (tetë milion) Lekë pa TVSH. Totali i pikëve të marra: 265.50 (I Kualifikuar)

III.1.4. Në datën 13.11.2024, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE “Formular Njoftim Fituesi Paraprak” për procedurën e prokurimit dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 80, datë 18.11.2024, në të cilën është shpallur fitues operatori ekonomik “CIVIL CONS” SHPK.

III.1.5. Operatori ekonomik “INSTITUTI I KONSULENCES NE NDERTIM "IKN" SHPK, rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit për arsytet si më poshtë:

“Skualifikohet oferta e paraqitur nga operatori ekonomikë “Instituti Konsulences Ndertim” sh.p.k pasi nuk ka arritur te paraqesë dokumentacion të plotë dhe të saktë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kriterëve të kërkuara në DST , konkretisht; -Nuk ka plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit sipas pikës 2.3.4. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin mbikëqyrës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë, konkretisht: - Mbikëqyrësin për punimet e mjedisit, që duhet të jetë Inxhinier Mjedisit me licencë dhe me eksperiencë pune në këtë fushë. Nga operatori ekonomik mbikëqyrësi per punimet e mjedisit, i paraqitur per kete procedurë nuk është Inxhinier Mjedisit i kerkuar qarte ne DST, por eshte Inxhinier Pyjesh. Sipas Termave të Referencës të shpallura për këtë procedurë prokurimi, si dhe natyrës së kesaj kontrate, kriteri i kërkuar për disponimin e Inxhinierit të Mjedisit si pjesë e realizimit, vendoset pasi kemi të bëjmë me zgjidhjen e problemeve mjedisore duke përdorur parime shkencore dhe inxhinierike. Roli kryesor i Inxhinierit te Mjedisit ne zbatimin e kesaj kontrate eshte per te zhvilluar apo krijuar strategji per riciklimin dhe menaxhimin e mbetjeve dhe te gjithë faktoreve te tjere qe ndikojne ne mjedis. Paraqitja e nje Inxhinieri Pyjesh per te plotësuar kete kriter nuk qendron pasi ne kete kontrate nuk kemi te bejme me praktika per shfrytëzimin e drurit apo menaxhimin e resurseve pyjore. Gjithashtu, Inxhinieri i pyjeve, nuk ka

trajnim të specializuar për të kryer detyrat e një Inxhinieri të mjedisit të nevojshëm për zbatimin e projektit dhe si i tillë nuk mund të paraqitet për përmbushjen e këtij kriteri”.

III.1.5.1. Në datën 11.11.2024 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2024/4772 dhe me nr. 3318/2024 prot., datë 12.11.2024 e operatorit ekonomik “INSTITUTI I KONSULENCES NE NDERTIM IKN shpk”, ku u konstatua se objekti i saj, lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik. Gjithashtu, kundërshton edhe vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertave të paraqitura nga ofertuesit pjesëmarrës të kualifikuar në këtë procedurë prokurimi, konkretisht, OE “ARENA MK” shpk; OE “CIVIL CONS” shpk; OE “HTS COMPANY” shpk; OE “INFRA – PLAN” shpk; OE “SEED CONSULTING” shpk; si dhe OE “TRANSPORT HIGHĒAY CONSULTING” shpk, të cilët pretendohet nga ankimesi se nuk përmbushin kriterin 2.3.4 të vendosur për kualifikim të bërë nga autoriteti kontraktor, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

III.1.5.2. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin për publikim Nr. 3318/2 prot., datë 13.11.2024 lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomikë “INSTITUTI I KONSULENCES NE NDERTIM IKN shpk”, që kundërshton me anë të ankesës me nr. 3318/2024 prot., datë 12.11.2024. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik publikoi pretendimet e ankimesit, që të skualifikohen operatorët ekonomikë OE “ARENA MK” shpk; OE “CIVIL CONS” shpk; OE “HTS COMPANY” shpk; OE “INFRA – PLAN” shpk; OE “SEED CONSULTING” shpk; si dhe OE “TRANSPORT HIGHĒAY CONSULTING” shpk, për mospërmbushjen e kriterit 2.3.4 nga ana e secilit ofertues.

III.1.5.3. Në përfundim të afatit 5 ditor, brenda të cilit autoriteti kontraktor ka detyrimin ligjor të trajtimit të ankesës dhe daljes me një vendim përfundimtar në lidhje me të, Komisioni i Prokurimit Publik me anë të shkresës nr. 3318/3 prot., datë 25.11.2024, i ka kërkuar autoritetit kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit për procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, të jepen argumentimet përkatëse mbi pretendimet e operatorit ekonomik “INSTITUTI I KONSULENCES NE NDERTIM IKN shpk”, si dhe vendimin e autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes.

III.1.5.4. Nëpërmjet shërbimit posta, është dërguar nga autoriteti kontraktor shkresa “Kthim përgjigje” me nr. 8995/1 prot., datë 04.12.2024, protokolluar me tonën me nr. 3318/4 prot., datë 10.12.2024.

III.1.6. Neni 24, pika 1, “Komisioni i prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij.”.

III.1.7. Neni 30, pika 1, “Veprimtaria e Komisionit të Prokurimit Publik” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera. Shqyrtimi i ankesave për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar do të bëhet nga 3 anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik”.

III.1.8. Në nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit.

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”.

III.1.9. Në nenin 111 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, është parashikuar se:

“1. Operatori ekonomik ankimes dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankimesi është i detyruar t’i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.

3. Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën

elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur.

4. Në çdo rast, paraqitja e ankesës shoqërohet me mandatpagesën e bërë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.”

Neni 112, pikat 1 dhe 2 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “1. Me marrjen e ankesës, autoriteti ose enti kontraktor konfirmon në databazën e të dhënave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik që ankesa është paraqitur pranë këtij institucioni. Nëse autoriteti ose enti kontraktor konstaton se ankesa nuk është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, e refuzon atë si të pavlefshme.

2. Pasi konfirmon se ankesa është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, autoriteti ose enti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik.”.

Në nenin 114, pikat 1 dhe 4, “Trajtimi i ankesës nga autoriteti ose enti kontraktor” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.

“4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.”.

Neni 118, “Vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “1. Komisioni i Prokurimit Publik, në çdo kohë pas marrjes së ankesës dhe para lidhjes së kontratës, kur nuk vendos pezullimin, mund ta lejojë autoritetin ose entin kontraktor, me anë të një vendimi të ndërmjetëm deri në marrjen e një vendimi përfundimtar, të vazhdojë procedurën e prokurimit nëse pezullimi dëmton tërthorazi interesin publik, autoritetin ose entin kontraktor ose ofertuesit.

2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë:

a) të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësisht të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji;

b) të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin;

c) të refuzojë ankesën dhe të lejojë autoritetin ose entin kontraktor të vazhdojë procedurën e prokurimit, kur gjykon se nuk ka shkelje të dispozitave ligjore;

ç) të nxjerrë vendim deklarativ për mbylljen e çështjes, sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 3 të nenit 115 të këtij ligji;

d) të refuzojë ankesën, e cila ka si objekt kundërshtimin e një vendimi të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik, në rast të një ankese tjetër që i përket të njëjtës procedurë, të paraqitur nga i njëjti operator ekonomik”.

III.1.10. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për procesin e vlerësimit të ofertave, është 7 ditë nga publikimi i njoftimit të fituesit ose i njoftimit të anulimit. Në rastin konkret, referuar verifikimeve në Sistemin e Prokurimit Elektronik, u konstatua se nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave u krye vlerësimi i ofertuesëve më datë 06.11.2024 dhe në datën 13.11.2024, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE “Formulari i Njoftimit të Fituesit Paraprak” për procedurën e prokurimit si dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike të Agjencisë së Prokurimit Publik, Buletini nr. 80, datë 18.11.2024, ku është shpallur fitues operatori ekonomik “CIVIL CONS” SHPK. KPP vëren se operator ekonomik ankimues “INSTITUTI I KONSULENCES NE NDERTIM IKN shpk ka dorëzuar ankimin elektronik në sistemin elektronik të ankesave në datën 11.11.2024 me nr. A/2024/4772 dhe me nr. 3318/2024 prot., datë 12.11.2024, duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt-ankimi. Gjithashtu, kundërshton edhe vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertave të paraqitura nga ofertuesit pjesëmarrës të kualifikuar në këtë procedurë prokurimi, konkretisht, OE “ARENA MK” shpk; OE “CIVIL CONS” shpk; OE “HTS COMPANY” shpk; OE “INFRA – PLAN” shpk; OE “SEED CONSULTING” shpk; si dhe OE “TRANSPORT HIGHWAY CONSULTING” shpk, të cilët pretendohet nga ankimuesi se nuk përmbushin kriterin 2.3.4 të vendosur për kualifikim të bërë nga autoriteti kontraktor, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se referuar nenit 111, pika 1 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Referuar dokumentacionit të administruar rezulton se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik përpara afatit të parashikuar nga neni 110, pika 2 e Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i cili parashikon se “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”, pasi nga ana e autoritetit kontraktor nuk ishte publikuar ende njoftimi i Fituesit të procedurës së prokurimit objekt-ankimimi, në momentin e dorëzimit të ankesës nga operatori ekonomik ankimues “INSTITUTI I KONSULENCES NE NDERTIM IKN shpk.

Referuar parashikimeve të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në rastin kur nga ofertat e dorëzuara në procedurën e prokurimit rezulton një ofertë e suksesshme, nis ditën e publikimit të njoftimit të Fituesit dhe përfundon në ditën e 7-të. Në rastin konkret, afati i paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik në momentin e paraqitjes së ankesës në datë 11.11.2024 me nr. A/2024/4772 dhe me nr. 3318/2024 prot., datë

12.11.2024, nuk kishte filluar akoma për sa kohë nuk ishte publikuar njoftimi i Fituesit të procedurës së prokurimit, kjo e lidhur specifikisht me këtë procedurë prokurimi, pasi nga shqyrtimi i ofertave të dorëzuara, në datën 13.11.2024, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE “Formular Njoftim Fituesi Paraprak” për procedurën e prokurimit dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 80, datë 18.11.2024, në të cilën është shpallur fitues operatori ekonomik “CIVIL CONS” SHPK.

Për sa më sipër, ankesa e depozituar në autoritetin kontraktor dhe në Komisionin e Prokurimit Publik, nga operatori ekonomik ankimues “INSTITUTI I KONSULENCES NE NDERTIM IKN shpk në datë 11.11.2024 me nr. A/2024/4772 dhe me nr. 3318/2024 prot., datë 12.11.2024, do të konsiderohet e paraqitur përpara afatit ligjor të ankimit, duke mos u legjitimuar *ratione temporis*. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ligji *stricto sensu* ka parashikuar, se ankesa dorëzohet njëherazi si pranë autoritetit ose entit kontraktor ashtu edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe është përgjegjësi e operatorit ekonomik ankimues, që të dorëzojë këtë të fundit njëherazi në të dy institucionet, brenda afatit të parashikuar në ligj.

Në nenin 118, pika 2, gërma “a” të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar parashikohet se: “ *Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji*”. Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit, ndaj përbën shkak për mospranimin e saj nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve, është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

III.1.11. Referuar pikës 2 të nenit 111 të LPP-së, Komisioni thekson, se ligjvënësi ka përcaktuar disa elemente të domosdoshme formale për paraqitjen e ankesës njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor. Një prej elementeve të domosdoshme për paraqitjen e ankesës është edhe dokumenti bankar, që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën. Ndërsa referuar pikës 3 të nenit 111 të LPP-së, Komisioni gjykon, se ligjvënësi i ka dhënë një mundësi ankimesve, që të korrigjojnë ankesat e tyre në rast se konstatohet mungesa e një apo më shumë elementeve formale të përcaktuara në pikën 2 të nenit 111 të LPP-së. Me anë të kësaj mundësie, ligjvënësi ka dashur të përcjellë frymën, se nuk mund t’i refuzohet e drejta e ankimit subjekteve që pretendojnë se dëmtohen ose rrezikojnë të dëmtohen nga një vendimmarrje e autoritetit kontraktor në mënyrë apriori, vetëm për shkak të disa mungesave formale, të cilat mund të korrigjohen lehtësisht brenda një afati të arsyeshëm, që nuk cenon parimin e efikasitetit në procedurat e prokurimit publik. Bazuar në dispozitën e mësipërme, për të konstatuar mungesat lidhur me elementet formale të ankesës, si dhe për të vënë në dijeni ankimesin lidhur me mungesat e konstatuara, është detyrim i autoritetit kontraktor, i cili duhet të njoftojë menjëherë ankimesin me çdo mjet të mundshëm, duke i lënë 2 ditë kohë për të korrigjuar elementet e domosdoshme formale të ankesës. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave të caktuara në LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga përgatitja e ofertës, shqyrtimi

i ofertave, ankimi, si dhe mundësia për të korigjuar mangësitë lidhur me elementet e domosdoshme formale të ankesës, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga lex specialis LPP, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme, lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.

Fakti që nuk ka korigjuar të metat e ankesës, si në rastin konkret pagimin e tarifës së ankesës, nuk e ka privuar këtë të fundit nga një prej të drejtave më themelore në procedurat e prokurimit publik, që është e drejta e ankimit. Referuar arsytimit, në kushtet kur bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk ka paguar tarifën financiare të ankesës, Komisioni gjykon, se ankesa me nr. Elektronik A/2024/4772 dhe me nr. 3318/2024 prot., datë 12.11.2024 e operatorit ekonomik “INSTITUTI I KONSULENCES NE NDERTIM IKN shpk, nuk plotëson një prej elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës, ndaj, bazuar në gërmën “a” të pikës 2 të nenit 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, kjo ankesë duhet refuzuar.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “INSTITUTI I KONSULENCES NE NDERTIM IKN shpk, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyen se: *“Skualifikohet oferta e paraqitur nga operatori ekonomikë “Instituti Konsulences Ndertim” sh.p.k pasi nuk ka arritur te paraqesë dokumentacion të plotë dhe të saktë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kriterëve të kërkuara në DST , konkretisht; -Nuk ka plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit sipas pikës 2.3.4. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin mbikëqyrës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë, konkretisht: - Mbikëqyrësin për punimet e mjedisit, që duhet të jetë Inxhinier Mjedisit me licencë dhe me eksperiencë pune në këtë fushë. Nga operatori ekonomik mbikëqyrësi per punimet e mjedisit, i paraqitur per kete procedurë nuk është Inxhinier Mjedisit i kerkuar qarte ne DST, por eshte Inxhinier Pyjesh. Sipas Termave të Referencës të shpallura për këtë procedurë prokurimi, si dhe natyrës së kesaj kontrate, kriteri i kërkuar për disponimin e Inxhinierit të Mjedisit si pjesë e realizimit, vendoset pasi kemi të bëjmë me zgjidhjen e problemeve mjedisore duke përdorur parime shkencore dhe inxhinierike. Roli kryesor i Inxhinierit te Mjedisit ne zbatimin e kesaj kontrate eshte per te zhvilluar apo krijuar strategji per riciklimin dhe menaxhimin e mbetjeve dhe te gjithë faktoreve te tjere qe ndikojne ne mjedis. Paraqitja e nje Inxhinieri Pyjesh per te plotësuar kete kriter nuk qendron pasi ne kete kontrate nuk kemi te bejme me praktika per shfrytëzimin e drurit apo menaxhimin e resurseve pyjore. Gjithashtu, Inxhinieri i pyjeve, nuk ka trajnim të specializuar për të kryer detyrat e një Inxhinieri te mjedisit të nevojshëm për zbatimin e projektit dhe si i tillë nuk mund të paraqitet për përmbushjen e këtij kriteri”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.2.1. Në shtojcën 9 për pika 2.3.4. “Kapaciteti teknik”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin mbikëqyrës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

1. Drejtuesin e projektit duhet të jetë Inxhinier Ndërtimi me licencë dhe me eksperiencë pune në mbikëqyrje, i cili mban përgjegjësi për zbatimin e projektit sipas kushteve teknike të zbatimit, ndjek e miraton cilësinë e punimeve si dhe veprat e artit nga pikëpamja strukturore; miraton materialet dhe volumet e punimeve, certifikatën e pagesës, mbajtjen, kontrollin dhe miratimin e gjithë dokumentacionit, miratimin e ndryshimeve të volumeve, korrespondencën me ARRSH.

2. Mbikëqyrësin për punimet topografike, që duhet të jetë Inxhinier Topograf / Gjeodet / Markshajder me licencë dhe me eksperiencë pune në këtë fushë, i cili kontrollon dhe miraton volumet, piktetimet dhe kuotëzimin e objektit.

3. Mbikëqyrësin (Gjeolog / Gjeoteknik), duhet të jetë Inxhinier Gjeolog / Gjeoteknik me licencë dhe me eksperiencë pune në këtë fushë, i cili kontrollon bazamentin e punimeve të mbushjes, punimet gjatë gërmimit, hapjet dhe thellësinë e themeleve të veprave të artit.

4. Mbikëqyrësin për punimet e sinjalistikës e të sigurisë rrugore, i cili duhet të jetë Inxhinier Mekanik me licencë dhe me eksperiencë pune në këtë fushë. Ai miraton materialet dhe cilësinë e tyre dhe ndjek e miraton cilësinë e punimeve të sinjalistikës horizontale e vertikale (të përkohshme dhe të përhershme), si dhe sigurinë rrugore, gjatë kryerjes së punimeve dhe pas tyre.

5. Mbikëqyrësin për punimet e mjedisit, që duhet të jetë Inxhinier Mjedisi me licencë dhe me eksperiencë pune në këtë fushë.

6. Mbikëqyrësin për punimet e drenazhimit, që duhet të jetë Inxhinier Hidroteknik me licencë dhe me eksperiencë pune në këtë fushë, i cili ndjek e miraton cilësinë e punimeve për drenazhimin e trupit dhe skarpateve të rrugës, veprave të vogla hidroteknike dhe vepra të mëdha (urë).

7. Mbikëqyrësi për punimet elektrike duhet të jetë Inxhinier Elektrik me licencë dhe me eksperiencë pune në këtë fushë, i cili ndjek punimet elektrike sipas projekt-preventivit.

*** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledëes të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr 10. "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese".

Për secilin pjesëtar të stafit mbështetës të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Licencë për mbikëqyrje punimesh, Diplomë, Librezë pune dhe CV. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

❖ **Stafi i kërkuar në pikën 2.3.4 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese.**

III.2.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatorit ekonomik ankimues “INSTITUTI I KONSULENCES NE NDERTIM IKN” SHPK, për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon:

- i. Licencë MK.1019/23 e shoqërisë “INSTITUTI I KONSULENCES NE NDERTIM” SHPK regjistruar në regjistrin profesional që nga data 05.06.2024, e vlefshme deri në datën 21.02.2028;
- ii. Formular përmbledhës vetdeklarimi e shoqërisë “ INSTITUTI I KONSULENCES NE NDERTIM” SHPK;
- iii. Licencë në mbikëqyerje dhe kolaudim MK.3102 e Z.I.M (ing. Pyjesh), regjistruar në regjistrin profesional që nga data 13.09.2017;
- iv. Licencë në projektim A. e Z.I.M (ing. Pyjesh), regjistruar në regjistrin profesional që nga data 13.09.2017;
- v. Dilpomë Nr. 4739, Z. I.M, i jepet titulli inxhinier pyjesh nga Fakulteti i Pyejeve të Institutit Lartë Shtetëror të Bujqësisë në degën shfrytëzim pyjesh, Tiranë 20.11.1975, Nr. Regj 3504;
- vi. Kontratë pune lidhur midis Z. I.M ing pyjesh dhe shoqërisë “ INSTITUTI I KONSULENCES NE NDERTIM” SHPK me nr. Rep.981 nr.kol.561 datë 03.05.2024;
- vii. Cv e Z.I.M (ing. Pyjesh) dhe Librez pune;

III.2.3. Në nenin 2 “*Qëllimi i ligjit*” të ligjit nr. 162/2021 “*Për prokurimin publik*” parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

Në nenin 3 “*Parime të përgjithshme*” të ligjit nr. 162/2021 “*Për prokurimin publik*” parashikohet se 1. *Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të*

këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. *Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.2.4. Neni 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

4. *Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

a) *licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*

III.2.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.2.6. Sa më sipër, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “INSTITUTI I KONSULENCES NE NDERTIM IKN” Shpk, në rastin konkret për përmbushjen e kriterit 2.3.4 (5. *Mbikëqyrësin për punimet e mjedisit, që duhet të jetë Inxhinier Mjedisit me licencë dhe me eksperiencë pune në këtë fushë*), ka dorëzuar dokumentacionin e cituar në pikën III.2.2.

Duke iu referuar kriterit, operatori ekonomik për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin mbikëqyrës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si «5. *Mbikëqyrësin për punimet e mjedisit, që duhet të jetë Inxhinier Mjedisit me licencë dhe me eksperiencë pune në këtë fushë*» dhe për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të provojë me dokumentacionin e kërkuar, që disponon stafit drejtues teknik të shoqërisë. Kriteri

konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr 10. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Për secilin pjesëtar të stafit mbështetës të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Licencë për mbikëqyrje punimesh, Diplomë, Librezë pune dhe CV.

Për sa më sipër, në rastin konkret operatori ekonomik “INSTITUTI I KONSULENCES NE NDERTIM IKN” SHPK, në licencën e dorëzuar për “*Mbikëqyrësin për punimet e mjedisit, që duhet të jetë Inxhinier Mjedisit me licencë dhe me eksperiencë pune në këtë fushë*», dokumentacionin provues se disponon kualifikimet e duhura të stafit teknik të shoqërisë, konkretisht për Inxhinier Pyjesh me eksperiencë profesionale mbi 10 vjet, ing. Pyjeve Z. I.M, të aftë për kryerjen e të gjitha shërbimeve sipas objektit të kësaj kontrate, për profilin përkatës. Komisioni i vlerësimit të ofertave e ka skualifikuar këtë operator ekonomik me arsyetimin se profili i diplomës së ing. Z. I.M. nuk përmbush profilin e kërkuar në kriterin pika 2.3.4. për inxhinier mjedisit, pasi ky i fundit ka Dilpomë Nr. 4739, Z. I.M, i jepet titulli Inxhinier Pyjesh nga Fakulteti i Pyjeve të Institutit Lartë Shtetëror të Bujqësisë në degën shfrytëzim pyjesh, Tiranë 20.11.1975, Nr. Regj 3504 shoqëruar edhe me Licencë në mbikëqyrje dhe kolaudim MK.3102 e Z.I.M (ing. Pyjesh), regjistruar në regjistrin profesional që nga data 13.09.2017 por jo inxhinier mjedisit sipas profilin të kërkuar referuar kriterit të hartuara në dokumentatat standarde.

Në lidhje me këtë pikë, ankimues sqaron se përpara datës së ofertimit i është drejtuar autoritetit kontraktor duke kërkuar sqarime mbi përmbushjen e kriterit 2.3.4 për “*Mbikëqyrësin për punimet e mjedisit, që duhet të jetë Inxhinier Mjedisit me licencë dhe me eksperiencë pune në këtë fushë*». Në kthim përgjigje për sqarim autoriteti kontraktor ka sqaruar në mënyrë shteruese operatorin ekonomik ankimues duke shpjeguar se, citoj “*Pëshëndetje Për sa i përket kërkesës suaj për sqarim në lidhje me stafin e kërkuar në pikën 2.3.4 të DST - ve, konkretisht, për Mbikëqyrësin për punimet e sinjalistikës e të sigurisë rrugore (Inxhinier Mekanik) dhe për Mbikëqyrësin për punimet e mjedisit (Inxhinier Mjedisit), ju bëjmë me dije se **stafi i cituar duhet të disponojë licencë individuale në mbikëqyrje dhe të ketë eksperiencë në këtë fushë. Kategoritë e licences për mbikëqyrjen e punimeve për secilën fushë të kërkuar (NS-6, NS-7, NP-12), duhen të mbulohen nga operatori ekonomik i interesuar për pjesëmarrje, në licencën e shoqërisë.** Pra, në përmbushje të kriterin 2.3.4 pika 5, duhet të dorëzohet dokumentacion nga ana e ofertuesit se disponon mbikëqyrësin për punimet e mjedisit, që duhet të jetë Inxhinier Mjedisit me licencë dhe me eksperiencë pune në këtë fushë dhe jo me diplomë Inxhinier Pyjesh.*

III.2.7. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimi por, edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentet e tenderit. Pra, për të plotësuar pikën e mësipërme të kërkesave për kualifikim për kategorinë dhe nivelet e licencimit, operatorët

ekonomikë duhet të paraqesin licencat profesionale, pasi për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme në realizimin e këtyre kategorive punimesh por, edhe në përputhje me nivelin e përcaktuar në kriterin 2.3.4. të dokumenteve të tenderit. Sa më sipër, KPP konstaton, se me dokumentacionin e paraqitur, operatori ekonomik ankimues “INSTITUTI I KONSULENCES NE NDERTIM IKN” SHPK nuk arrin të vërtetojë se plotëson kriterin 2.3.4 /5 (për inxhinierin e mjedisit), të kapacitetit teknik të dokumenteve të tenderit.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “INSTITUTI I KONSULENCES NE NDERTIM IKN” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimmarrjes së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertave të paraqitura nga ofertuesit pjesëmarrës të kualifikuar në këtë procedurë prokurimi, konkretisht, OE “ARENA MK” shpk; OE “CIVIL CONS” shpk; OE “HTS COMPANY” shpk; OE “INFRA – PLAN” shpk; OE “SEED CONSULTING” shpk; si dhe OE “TRANSPORT HIGHWAY CONSULTING” shpk, të cilët pretendohet nga ankimuesi se nuk përmbushin kriterin 2.3.4 të vendosur për kualifikim të bërë nga autoriteti kontraktor, në procedurën e prokurimit të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës. Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real (përkundrejt atij imagjinar) nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi, duke mos pasur më interes të ligjshëm në lidhje me këtë procedurë prokurimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranohet ankesën me nr. elektronik A/2024/4772 dhe me nr. 3318/2024 prot., datë 12.11.2024 si dhe ankesën me numër ankimi elektronik A/2024/4797 dhe me nr. 3377/2024

prot., datë 18.11.2024 e paraqitur nga operatori ekonomik “INSTITUTI I KONSULENCES NE NDERTIM IKN” SHPK, në procedurën e prokurimit “E Hapur, e thjeshtuar - Shërbime – Prokurim me mjete elektronike” me nr. **REF-24751-10-15-2024**, me objekt: “**Supervizion punimesh Ndertim rruga kthesa e Berdices - Ura e Bahcallekut**” me fond limit **9,191,815.2** (nëntë milion e njëqind e nëntëdhjetë e një mijë e tetëqind e pesëmbëdhjetë presje dy), zhvilluar më datë 30.10.2024 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm.
3. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “INSTITUTI I KONSULENCES NE NDERTIM IKN” SHPK
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri